



### Fleta e punës për nxënësit 3.5

#### Koncepti i së mirës së përbashkët: vula e demokracisë dhe diktaturës

*La multitude qui ne se réduit pas à l'unité est confusion, l'unité qui ne dépend pas de la multitude est tyrannie.*

[Diversiteti që nuk mund të reduktohet në unitet është konfuzion; uniteti që injoron diversitetin është tirani.]

*Blaise Pascal (1623-1662)*

Negocimi i së mirës së përbashkët në demokracitë pluraliste	Imponimi i së mirës së përbashkët nën sundimin autoritar dhe diktaturë
	
<p>Në demokracitë pluraliste, e mira e përbashkët është e negociuar dhe e argumentuar. Askush nuk e di rezultatin më parë (AB?). Provat dhe gabimet janë shpesh të përfshira, kështu që vendimet mundet, dhe nganjëherë duhet, të korrigjohen. Politika është një proces i të mësuarit kolektiv përmes debatit të diskutueshëm; e më në fund, duhet të merret një vendim.</p>	<p>D1: përmes njohurisë hyjnore apo analizave shkencore (p.sh. marksizëm-leninizmi) e mira e përbashkët mund të përcaktohet objektivisht. Vetëm elita në pushtet është e aftë për të bërë këtë (D2!). E mira e përbashkët e justifikon çdo mjet, duke përfshirë forcën, për të kapërcyer rezistencën e opozitës (X). Kritikët e "D1" ose "D2!" denoncohen si armiq.</p>
<p>Në demokracitë pluraliste, grupet promovojnë qëllime, interesa dhe vlera të ndryshme (Qëllimet A dhe B). Secili grup argumenton qëllimet e saj (A1, A2, B1, B2), duke u përpjekur të ndikojë në vendimin përfundimtar në favor të tyre (AAB? – BBA?). Pluralizmi nxit konkurrencë dhe polemika. Media e lirë mbështet debatet e gjalla.</p>	<p>Në diktatura, grupe apo individë që promovojnë një alternativë ose që artikulojnë kritika bëhen të heshtin (simboli-X). E drejta për pjesëmarrje është dhënë vetëm për përkrahësit e regjimit. Mediat janë të censuruara. Sundimtari vendos çfarë problemesh, interesash apo qëllimesh pranohen në agjendën politike.</p>
<p>Polemika konsiderohet si e nevojshme dhe produktive për të arritur marrëveshje dhe kompromis. Vendimet janë të hapura për shqyrtim kritik.</p>	<p>Pëlqimi zbatohet dhe paracaktohet nga drejtuesi. Kontradiktat konsiderohet pa harmoni dhe të rrezikshme, pasi është e vështirë t'i kontrollosh.</p>